# Ndërrimi i fjalëkalimit (password) përmes Outlook Web App-it

## Hapi i parë - Qasja:

Për te qasur në Outlook Web App ju duhet te hyni në link-un: https://mail.rks-gov.net/owa pastaj do te ju shfaqet dritarja si ne figurën 1.




*Figura 1- Dritarja për qasje ne Outlook Web App brenda rrjetit Qeveritar*




*Figura 2- Dritarja për qasje ne Outlook Web App jashtë rrjetit Qeveritar*

Për tu qasur në Outlook Web App kërkohet llogaria elektronike (**username)** dhe fjalëkalimi (**password** ) i juaj, ju lutem shënoni të dhënat e llogarisë suaj.

Informatë:
Domen-et qe përdoren në Institucionet e Kosovës janë:
Zyrtarët në (Ministri, Agjenci, Institute qeveritare..) **gov\emri.mbiemri**
Zyrtarët në Kuvend të Kosovës **krk\emri.mbiemri**
Zyrtarët në Gjykate Kushtetuese **gjkk\emri.mbiemri**
Zyrtarët në ZKM **pm\emri.mbiemri**
Zyrtarët në Komuna **mun\emri.mbiemri**
Zyrtarët në MPB **mpb\emri.mbiemri**
Zyrtarët në MD **md\emri.mbiemri**
Zyrtarët në IPK **ipk\emri.mbiemri**

# Hapi i dytë - Settings:

Pasi që të jeni kyçur në Outlook Web App atëherë klikoni në ( **settings**), pastaj kliko **change password** për të ndërruar fjalëkalimin, ju lutem ndiqni hapat siç janë paraqitur në figurën 3.




*Figura 3 - Dritarja për tu qasur në menynë e ndërrimit të fjalëkalimit.*

# Hapi i tretë – Ndërrimi i fjalëkalimit

Te plotësohen te dhënat ne dritaren e hapur si ne figurën 4:

1. Në fushën **Current password** shëno fjalëkalimin tuaj aktual (të vjetër)
2. Në fushën **New password** shëno fjalëkalimin tuaj të ri
3. Në fushën **Confirm new password** përsërit fjalëkalimin tuaj të ri
4. Kliko **Save** për të ruajtur ndryshimin e bërë.




*Figura 4 – Dritarja për ndërrim te fjalëkalimit ( password)*

***Informatë:***

*Fjalëkalimi i ri kompleks duhet te përmbaj minimum 8 karaktere dhe te përdoren minimum 3 kategoritë e mëposhtme:*

*Shkronja e madhe...........................( A – Z )*

*Shkronja e vogël.............................( a – z )*

*Numër............................................( 0 – 9 )*

*Simbol............................( ! $ # %*)”: etj.).*

# Hapi i pestë – ri-kyçja në Outlook Web App

Hapi i fundit është qasja në Outlook Web App, e cila behet njëjtë sikur në figurën 2, mirëpo tani duke përdorur fjalëkalimin e ri kompleks.




*Figura 5 - Dritarja per qasja në Outlook Web App duke përdorur fjalëkalimin e ri*

***Vërejtje: Ky fjalëkalim i juaj përdoret per qasje në shërbimet elektronike siç janë: Posta elektronike zyrtare, sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemi i menaxhimit të pasurisë, sistemi i arkivës elektronike, sistemi i vijueshmërisë në punë, sistemi i LYNC si dhe qasja në kompjuterin tuaj.***